

Fatmir Smajli

Data e lindjes: 1979

Vendbanimi: Prishtinë, Kosovë

Gjuhët: Shqip (amtare), Anglisht, Italisht

Profili

Fatmir Smajli është një lider i fuqishëm dhe politikani i angazhuar në politikë të spektrit të djathtë, me një eksperiencë të pasur në politikë, biznes, dhe aktivizëm shoqërorë e humanitar. Fatmiri është veteran i Luftës Çlirimtare të Kosovës (1998/1999) dhe përkrahës i luftave të shqiptarëve për të drejta dhe dinjitet në Luginë dhe IRJM. Fatmiri është i njohur për zërin e tij të fuqishëm në mbështetjen e kauzave të drejta për Kosovën dhe komunitetin e tij. Duke kombinuar përvojën në politikë, në angazhime shoqërore dhe udhëheqje efektive të kompanive të suksesshme, z. Smajli është një figurë me ndikim dhe kontribut në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Studimet dhe certifikimet në një gamë të gjerë të fushave, nga Menaxhmenti dhe Informatika, tek teknologjia, mjekësia, ndërtimtaria, prokurimi dhe administrata e bëjnë Fatmirin profil të denjë për angazhim në politikë.

Besimi, vlerat personale e familjare, dedikimi i hershëm dhe i pa ndërprerë ndaj kauzave publike janë mburoja e integritetit të Fatmirit.

ARSIMIMI

Master në Menaxhment dhe Informatikë

Fakulteti Ekonomik, 2014

Bachelor në Menaxhment dhe Informatikë

Fakulteti Ekonomik, 2012

EKSPERIENCA PROFESIONALE

CEO - Astronik sh.p.k

2013 – sot

- Drejtues i një kompanie të suksesshme të teknologjisë, e specializuar në sektorët e shtypit, skanimit, menaxhimit të dokumentacionit, digjitalizimit, pajisjet e IT-së.
- Ndërtimi dhe zgjerimi i biznesit në tregjet vendore dhe ndërkombëtare.

- Udhëheqësi i një ekipi të suksesshëm në implementimin e teknologjive inovative.

Kandidat për deputet

Zgjedhjet Parlamentare, 2017

- Kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës, duke promovuar politika të djathta në mbrotje dhe promovim të traditave, familjes dhe vlerave autoktone të këtij populli, në promovim të zhvillimit ekonomik, transparencës dhe përmirësimit të shërbimeve publike.
- Angazhim për fuqizimin e sektorit privat dhe mbështetjen e bizneseve të vogla dhe të mesme.

EKSPERIENCA NË AKTIVIZËM

- Në rininë e hershme i aktivizuar në aktivitete shkollore dhe jashtëshkollore për të mbajtur lartë dinjitetin dhe kauzën e popullit shqiptar për t'i rezistuar shovenizmit serb.
- Qysh në momentet e para bashkë me të gjithë vëllezërit mobilizohet në Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (1998/1999), e prej aty e tutje i angazhuar për mbrojtjen e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës.
- Përvojat dhe njohuritë e fituara në fushën e teknologjisë, e gjejnë Fatmirin të angazhuar në ndërtimin e infrastrukturës së teknologjisë në Institucionet Publike të Kosovës, kontribut ky i cili i ka dhuruar edhe njohurinë e institucioneve, proceseve dhe ka ndërtuar rrjetin e bashkëpunëtorëve me profesionistë e patritot të dëshmuar.
- Aktivist humanitar me një angazhim të vazhdueshëm në mbështetjen e kauzave humanitare dhe zhvillimin e komunitetit që nga paslufta e deri më sot.

AFTËSI DHE CERTIFIKIME

- **Lider i aftë dhe i zgjuar** në fushën e menaxhimit dhe teknologjisë së informacionit.
- **I certifikuar për shërbimin dhe shitjen e produkteve RICOH dhe TOSHIBA**, si dhe për softuerët si PeaperCut dhe Umango.
- **Ofrimi i produkteve dhe shërbimeve nga brendet HP, Dell, SmartBoard, Katun etj.**

- **Njohuri të thelluara në procedurat e tenderimit dhe ligjin e prokurimit në Kosovë.**
- **Studime në fushën e mjekësisë dhe ndërtimtarisë.**

CERTIFIKIMET PROFESIONALE:

- Procedurat e tenderimit dhe ligji i prokurimit në Kosovë
 - RICOH Products Certification
 - Toshiba Product Marketing Training
 - Umango Expert
 - Toshiba Ambassador
-

Aftësi të Tjera

- **Aftësi të shkëlqyera në komunikimin ndërkulturor dhe ndërkombëtar, falë njohurive të gjuhëve të huaja.**
 - **Fuqizim i sektorit privat** përmes inovacioneve teknologjike dhe strategjive menaxheriale të suksesshme.
 - **Digjitalizimi i kompanive, institucioneve publike dhe shkollave.**
-

Personale

Fatmir Smajli është i martuar dhe baba i katër fëmijëve. Vjen nga një familje me vlera dhe kontribute të çmuara për vendin e shoqërinë në të gjitha periudhat historike. Originën e ka nga fshati Ramun, Pejë, por jeton dhe vepron në Prishtinë.